

VENDIM
Nr. 37, datë 9.2.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS SË TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË SHOQËRISË “HEC DUNICË”, ME NR. 124, SERIA T11P,
MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s NR. 28,
DATË 10.3.2011.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 42, germa “ç”, “d” dhe “dh” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë të elektrike”; të nenit 18, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; të nenit 5, gerrat “d” dhe “dh”; të nenit 6 të “Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, të miratuar me vendimin e bordit nr. 54, datë 18.4.2017, pika 6.1, gerrat “d” dhe “dh” të kushteve të “Licencës së tregtimit të energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 97, datë 17.6.2016 dhe të nenit 19, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 9.2.2018, pasi shqyrtoi, relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “HEC Dunicë”, me nr. 124, seria T11P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011,

konstatoi se:

- Subjekti tregtar “HEC Dunicë” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011, në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, me licencë nr. 124, seria T11P.

- Shoqëria tregtare “HEC Dunicë” sh.p.k. ka paraqitur në ERE kërkesën me nr. 08 prot., datë 19.1.2018, protokolluar me tonën nr. 104, datë 23.1.2018, për heqjen e licencës së tregtimit të energjisë elektrike, si dhe heqjen e pagesës së rregullimit për vitin 2017.

- Referuar shkresave të komunikimit në vijim me MEI-n, me nr. 46/49 prot., datë 26.4.2017 dhe shkresën me nr. 46/51 prot., datë 14.6.2017, rezulton se subjekti deklaron se është në kushtet e paaftësisë për të vazhduar aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike dhe për rrjedhojë kërkon heqjen e licencës.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “HEC Dunicë” sh.p.k., me nr. 124, seria T11P, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 28, datë 10.3.2011, për tregtimin e energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë shoqërinë “HEC Dunicë” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Petrit Ahmeti